



KUVENDI I KOMUNËS SUHAREKË

01 Nr. _____

Dt. 18.05.2006.

RR E G U L L O R E

PËR MENAXHIMIN E VARREZAVE

Maj 2006



Duke u bazuar ne nenin 3 te Rregullores për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës 2000/45 si dhe në nenin 19 te Statutit te Kuvendit të Komunës së Suharekës Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datë 18.05.2006 nxjerr këtë:

RR E G U L L O R E PËR MENAXHIMIN E VARREZAVE

I . KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve të varrimit si dhe rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Suharekës.

Neni 2.

Me shërbime të varrimit në kuptim të nenit paraprak nënkuptojmë të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me varrimin e personave të vdekur, siç janë:

- leja për zhvarrimin e eshtrave të mbetur të personave të vdekur në varrin e caktuar
- leja për vendin e varrosjes
- transporti i personave të vdekur prej vendit ku merret deri te vendi i varrimit
- hapja e varrit – vendosja, gjegjësisht mbulimi i varrit
- kujdesi i mirëmbajtjes së varrezave
- si dhe veprime tjera në lidhje me varrimin.

Neni 3.

- varrimi mund të bëhet vetëm në vendin i cili është i lejuar për këtë qëllim
- përjashtimisht, kur këtë e diktojnë kushte të jashtëzakonshme (vis malor) kjo mund të bëhet edhe në hapësira tjera përderisa zgjasin kushtet e jashtëzakonshme.

Neni 4.

Varrezat janë tokat të cilat janë përcaktuar për varrimin e personave të vdekur me Planin urbanistik komunal apo me vendim të Kuvendit Komunal.

Neni 5.

Punët e shërbimeve të varrimit i kryen Ndërmarrja komunale apo organizata të cilës Kuvendi Komunal ia ka besuar këto shërbime.

Varrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave nëpër fshatra lejohet ta bën bashkësia lokale gjegjësisht komuniteti fetar i fshatit, nëse për këtë jep pëlqimin komuniteti i lokalitetit dhe ndërmarrja komunale.

II . VARRIMI

Neni 6.

Me varrim nënkuptojmë mbulimin e trupit të personit të vdekur (kufomës) apo eshtrave të personave të vdekur, gjegjësisht, vendosja e hirit të kufomës) apo eshtrave të personave të vdekur, gjegjësisht, vendosja e hirit të kufomës së djegur në thellësi të tokës së caktuar të varrezave.

Neni 7.

Varrimi mund të bëhet pas konstatimit të vdekjes sipas rregullave të posaçme. Varrimi mund të bëhet pas konstatimit të vdekjes kurse ndërmarrja për shërbimet e varrimit duhet të lajmërohet së paku 6 orë para varrimit.

Neni 8.

Ndërmarrja e autorizuar është e obliguar që të sigurojë personelin për shërbime të varrimit për çdo ditë prej orës 7⁰⁰ - 19⁰⁰.

Neni 9.

Varrimi i kufomës (eshtrave të mbetur) bëhet në varrezat e vendbanimit të personit të vdekur.

Varrimi i kufomës mund të bëhet edhe në vendin të cilin personi e ka rezervuar apo vendin ku dëshiron ta varrosë familja e të vdekurit.

Neni 10.

Lejen për varrimin në varrin e caktuar e jep Ndërmarrja komunale gjegjësisht bashkësia lokale (fetare) e fshatit nëpër fshatra.

Neni 11.

Transportin e kufomës (eshtrave të mbetur) mund ta bën Ndërmarrja komunale me automjetin special për këtë qëllim (nëse ka automjet), apo komuniteti i lokalitetit.

Neni 12.

Kufoma e personit të caktuar mund të ruhet në morg deri në kohën e varrimit nëse varrezat kanë morgun.

Kufoma deri në varrim, mund të ruhet edhe në ndonjë objekt fetar, me lejen e bashkësisë fetare të komunitetit.

Neni 13.

Kufoma e personit të caktuar, me leje të organeve komunale, mund të vendoset para varrimit në një vend të caktuar, për t' i shprehur nderimet ndaj të vdekurit.

Neni 14.

Nderimet e fundit ndaj të vdekurit mund të shprehen në Sallën për homazhe (vendi i tubimit) apo pranë varrit të tij.

Gjatë varrimit mund të kryhen ceremonitë fetare që janë në pajtim me rregullat e komunitetit fetar ose me dëshirën e të afërmeve të të vdekurit.

Neni 15.

Djegia e eshtrave të kufomës bëhet vetëm në krematorium.

Djegia e eshtrave të kufomës bëhet vetëm nëse i vdekuri gjatë jetës ka shprehë dëshirën që kufoma e tij të digjet.

Djegia e kufomës në rastet kur vdekja ka ndodhur në mënyrë jo të natyrshme, mund të bëhet vetëm me lejen e organeve gjyqësore.

Neni 16.

Hiri i kufomës së djegur duhet të vendoset në enë prej materialit të qëndrueshëm dhe të mbyllur hermetikisht, i cili pastaj mbulohet në varrin e caktuar.

Neni 17.

Eshttrat e mbetur të kufomës mund të zhvarrosen dhe të barten në varrin tjetër, me lejen e organeve përgjegjëse dhe me lejen e inspeksionit sanitar.

III . VARREZAT

1. Hapja (ndërtimi) i varrezës

Neni 18.

Çdo vendbanim mund të ketë varreza.

Dy ose më shumë vendbanime mund të kenë varreza të përbashkëta.

Neni 19.

Varrezat që janë në funksion duhet të kanë:

- lokacioni i varrezave duhet të jetë në përputhje me kërkesat tekniko-sanitare dhe urbanistike
- objektet për shërbime të varrimit (morgu, personeli, shitoret etj)
- hyrje-daljet e rrugëve
- hapësira për përcaktimin e vendeve të varrimit sipas mundësive edhe vendi ku punohen arkivolet dhe përmendoret.
- Infrastruktura e nevojshme
- Rrethoja e varrezave

Infrastruktura e cekur në paragrafin paraprak detyrimisht duhet të jetë në përputhje me kërkesat e veçanta të konfeksioneve të ndryshme.

2. Përcaktimi dhe vendimi për ndalimin e varrezave

Neni 20.

Kuvendi Komunal merr vendim që varrezat të mbeten jashtë përdorimit apo të ndalohej varrimi i kufomave në varreza.

Neni 21.

Organi mbikëqyrës apo Ndërmarrja komunale mund t'a ndalojë varrimin e kufomave në një pjesë të caktuar, nëse konstatohet se nuk ka vend të mjaftueshëm.

3. Shfrytëzimi i vendeve të varrimit

Neni 22.

Hapësira që shfrytëzohet për varre ndahet në parcela, brenda të cilave gjinden vendet për varre.

Neni 23.

Varri është vendi ku vendoset kufoma (eshtrat e mbetur-hiri) të personit të vdekur.

Neni 24.

Për rezervimin e varrit, vendosjen e përmendores dhe shërbimet e varrimit në lidhje me varrimin apo eks-humimin e eshtrave të personit të vdekur, paguhet çmimi që e cakton Ndërmarrja komunale.

Neni 25.

Kuvendi Komunal me vendim të posaçëm, mund të vendosë që eshtrat e të vdekurve të varrosur në varreza, të zhvarrosen dhe të vendosen në një

vend tjetër, për qëllime në interes të komunës apo për shkak të ndryshimeve në Planin urbanistik.

4. Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave

Neni 26.

Varrezat rregullohen dhe mirëmbahen sipas zakoneve të komunitetit fetar të atij lokaliteti – vendbanimi që ka të bëjë me respektin dhe nderimet ndaj të vdekurve.

Në pamje, shenja, simbole dhe mbishkrime në përmendore dhe pllaka përkujtimore, nuk duhet të ofendohen ndjenjat patriotike, fetare apo nacionale të komuniteteve tjera.

Neni 27.

Ndërtimi, renovimi, ngritja apo heqja e përmendores apo pllakës përkujtimore pranë varrit, duhet të bëhet me lejen e organit kompetent (Ndërmarrjes komunale) sipas normave dhe standardeve përkatëse.

Neni 28.

Me mirëmbajtje të varrezave nënkuptojmë:

- ndërtimi dhe mirëmbajtja e varrezave, përmendoreve, pllakave etj.
- mirëmbajtja e gjelbërimit
- mirëmbajtja e rrethojës së varrezave, rrugëve pranë varrezave, infrastrukturës (rryma, uji, kanalizimi, ndriçimi etj).
- mbajtja e pastërtisë dhe të tjera.

Neni 29.

Rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave e kryen Ndërmarrja komunale gjegjësisht komuniteti fetar (i vendbanimit).

Neni 30.

Në varreza mund të kryhen edhe punë ndërtimore, por me lejen e Ndërmarrjes komunale apo komunitetit të vendbanimit.

Neni 31.

Në varreza mund të vendosen lule dhe kurora lulesh.

Kur këto të thahen, Ndërmarrja komunale është e obliguar që t'i heq ato.

Neni 32.

Ndërmarrja komunale apo komuniteti të vendbanimit është i obliguar që t'i mbrojë varrezat nga dëmtimi, rrëzuarja apo shkatërrimi i tyre.

Neni 33.

Disa varre mund të shpallen si monumente kulturore-historike me vendim të posaçëm dhe janë nën mbrojtje të Ministrisë së Kulturës.

Neni 34.

Evidencën për varreza, varrime, objekte përkujtimore dhe varrosjen e personave të vdekur e mban Ndërmarrja komunale, si dhe komuniteti i vendbanimit ose konfeksioni përkatës.

5. Puna në varreza

Neni 35.

Vizitorët e varrezave janë të obliguar që në varreza të sillen në mënyrë të sjellshme në shenjë nderimi dhe respekti ndaj të vdekurve.

Neni 36.

Fëmijët nën moshën 10 vjeçare kanë të drejtë të marrin pjesë (vizitojnë) varrezat vetëm në përcjellje të personave të moshuar.

Neni 37.

Ndërmarrja komunale në bashkëpunim me komunitetin vendos orarin dhe rendin se kur mund të vizitohen varrezat. Po ashtu mund të merr vendim për ndërprerjen e përkohshme të vizitave.

Ndërmarrja komunale – komuniteti nëpër fshatra janë të obliguara që këto rregulla mbi rendin, orarin dhe aktivitetet tjera, t'i shkruajnë dhe vendosin në hyrje të varrezave në një vend të dukshëm për të gjithë vizitorët.

Neni 38.

Në varreza është e ndaluar:

- të shkelën, të njollosën, dëmtohen apo shkatërrohen varrezat
- të shkatërrohen apo dëmtohen përmendoret, pllakat apo objektet tjera
- të prishet rendi dhe qetësia në varreza
- të kërcen varret, thyhet rrethoja, të shkelet gjelbërimi, dëmtohen pemët lulet etj.
- Të futen shtazët brenda.
- Të vendoset apo futet në varreza ushqimi dhe pijet e ndryshme, përveç kur lejohet me ritet fetare.
- Të vendosen flamujt apo shenja tjera shtetërore, përveç në varreza të dëshmorëve.

- Të krijohet papastërti dhe mbeturina të ndryshme.
- Të hyhet në morg pa lejen e Ndërmarrjes komunale gjegjësisht komunitetit të vendbanimit.
- Të mbillet pemë apo lule pa lejen e Ndërmarrjes komunale – komunitetit.
- Të kërkohet lëmoshë

IV . MJETET PËR PUNË

Neni 39.

Ndërmarrja komunale apo komuniteti i vendbanimit, mjetet e mirëmbajtjes i sigurojnë prej shërbimeve të varrimit nga qytetarët.

Mjetet për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të qytetit, sigurohen nga shërbimet komunale të varrimit që paguajnë qytetarët dhe nga buxheti komunal.

Mjetet për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave përkujtimore i siguron Kuvendi Komunal.

Çmimin e tarifës për varrime, shërbime komunale dhe aktivitete tjera, e cakton Kuvendi i Komunës sipas propozimit të Ndërmarrjes komunale.

Kompensimin e shpenzimeve të varrimit për personat e vdekur të cilët janë të paidentifikuar ose të cilët pas vetes nuk kanë lënë asnjë të afërm e bën Kuvendi i Komunës nga buxheti i vet, përkatësisht komuniteti i vendbanimit.

V. MBIKQYRJA

Neni 40.

Mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregullore e bën Kuvendi Komunal dhe Inspekcioni sanitar.

Neni 41.

Kuvendi Komunal gjegjësisht Inspeksioni sanitar janë të obliguar që të marrin këto masa:

- që varrimi i kufomave të bëhet sipas normave sanitare dhe sipas kësaj Rregulloreje
- që të përcjellin realizimin e planit për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave dhe japin urdhra për kryerje të detyrave.

- që të urdhërojnë kryerjen e punëve të caktuara mbi rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.
- që të ndalohet përkohësisht varrimi i kufomave, për arsye sanitare
- që të urdhërojnë përkohësisht varrimin në një pjesë të caktuar të varrezave.
- që të ndërprejnë punën, të heqin pllakën përkujtimore apo ndonjë objekt tjetër ose të urdhërojnë që kjo të bëhet sipas normave dhe rregullave

Neni 42.

Çdo gjë që nuk parasheh kjo Rregullore, mund të rregullohet me akte normative të Kuvendit të Komunës përkatësisht të Ndërmarrjes komunale me pëlqimin e Kuvendit të Komunës.

Neni 43.

Kjo Rregullore hyn në fuqi tetë ditë pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Suharekës.

KUVENDI I KOMUNËS - SUHAREKË

01.nr. _____
Suharekë, datë _____

Kryetari i Kuvendit

Sali Asllanaj